

Njoftim për përfundimin e konkursit për pozicionin “specialist” në Shërbimin e Protokollit pranë Shërbimit të Marrëdhënieve me Jashtë, pa kandidatë fitues

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kreut IV – “Pranimi në shërbimin civil”, neni 22, pika 5 dhe neni 23, pika 1, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, kreut III, “Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivel ekzekutiv”, pika 3 dhe kreut IV, “Konkurrimi”, pika 20, Komiteti i Përhershëm i Pranimit në përfundimin e procedurës të testimit me shkrim, vlerësimit të CV, intervistës të strukturuar me gojë, për konkursin në pozicionin “specialist”, në Shërbimin e Protokollit pranë Shërbimit të Marrëdhënieve me Jashtë, vendosi përfundimin e konkursit, pa asnjë kandidat fitues.